



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 628/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

### V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2021:

- Fizikë, BSc, 180 ECTS, (maksimum 80 studentë për vit akademik);
- Fizikë, MSc, 120 ECTS, (maksimum 20 studentë për vit akademik);
- Gjeografi, BSc, 180 ECTS, (maksimum 70 studentë për vit akademik);
- Gjeografi, MSc, 120 ECTS, (maksimum 20 studentë për vit akademik).

II. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Biologji, BSc, 180 ECTS, (maksimum 120 studentë për vit akademik);
- Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, BSc, 180 ECTS, (maksimum 90 studentë për vit akademik);
- Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, MSc, 120 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik);
- Biologji e Organizmave dhe Ekologji, PhD, 180 ECTS, (maksimum 10 studentë për vit akademik);
- Kimi Analtike dhe Mjedis, MSc, 120 ECTS, (maksimum 20 studentë për vit akademik);
- Kimi, BSc, 180 ECTS, (maksimum 90 studentë për vit akademik);

- Kimi Fizike dhe Inorganike, MSc, 120 ECTS, (maksimum 20 studentë për vit akademik);
- Kimi Inxhinierike, BSc, 180 ECTS, (maksimum 75 studentë për vit akademik);
- Kimi Organike, MSc, 120 ECTS, (maksimum 20 studentë për vit akademik);
- Kimi, PhD, 180 ECTS, (maksimum 10 studentë për vit akademik).

III. Nuk akreditohet programi i studimit:

- Kimi Ushqimore, BSc, 180 ECTS.

IV. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

V. Obligohet Fakultetit i Shkencave Matematike – Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm te stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

VI. Obligohet Fakultetit i Shkencave Matematike – Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

## A r s y e t i m i

Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Fizikë	BSc	180	Skender Kabashi, Shukri Klinaku, Sefer Avdijaj
2	Fizikë	MSc	120	Naim Sylaj, Gani Jashari, Sadik Bekteshi
3	Gjeografi	BSc	180	Florim Isufi, Vlbon Bytyç, Fitim Humolli
4	Gjeografi	MSc	120	Ibrahim Ramadani, Ferim Gashi, Arsim Ejupi
5	Biologji	BSc	180	Hazbije Sahiti, Kimete Lluga-Rizani, Kasum Letaj
6	Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit	BSc	180	Halil Ibrahim, Elez Krasniqi, Kemajl Kurteshi
7	Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit	MSc	120	Avni Hajdari, Ferdije Zhushi-Etemi, Enver Sherifi

8	Biologji e Organizmave dhe Ekologji	PhD	180	Avdulla Alija, Behxhet Mustafa, Agim Gashi
9	Kimi Analtike dhe Mjedis	MSc	120	Tahir Arbneshi, Fatbardh Gashi, Naser Troni
10	Kimi	BSc	180	Bashkim Thaçi, Albert Maxhuni, Ilir Shehu
11	Kimi Fizike dhe Inorganike	MSc	120	Musaj Paçarizi, Teuta Selimi, Liridon Berisha
12	Kimi Inxhinierike	BSc	180	Makfire Sadiku, Fatmir Faiku, Skender Demaku
13	Kimi Organike	MSc	120	Majlinda Ajvazi-Daci, Bardha Korça, Hamit Ismaili
14	Kimi	PhD	180	Sevdije Govori, Ismet Hashani, Ramiz Hoti
15	Kimi Ushqimore	BSc	180	Avni Berisha, Arleta Rifati-Nixha, Arben Haziri

AKA ka organizuar vizitë në Fakultetin e Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” më 30.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Henrik Toft Jensen, Prof. Dr. Jens Hoegaard Jensen, Prof. Dr. Peeter Normak, Prof. Dr. Fekete Csaba, Prof. Dr. Mladen Krajacic, Prof. Dr. Predrag Novak, Prof. Dr. Vladislav Tomisic, dhe Ms. Arus Harutyunyan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Kimi Ushqimore, BSc, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, qëllimi i këtij programi të studimit është dhënë në raportin e vet vlerësimit mirëpo realisht këto qëllime nuk përmbushen. Programi i studimit sipas ekspertëve duhet të planifikohet më me kujdes për sa i përket nevojave ekonomike të Kosovës, posaçërisht sa i përket industrisë së ushqimit. Po ashtu është e nevojshme që të bëhet një analizë e detajuar në lidhje me nevojat e tregut dhe ofertave të punës në këtë fushë. Sipas ekspertëve këto të dhëna mungojnë dhe në këtë drejtim nuk e arsyetojnë programin e studimit. Për më tepër, ekspertët kanë thënë se programi i studimit përmban

shumë lëndë bazike dhe vetëm disa nga to lidhen me kiminë ushqimore. Programi i studimit duplifkohet tej mase me programin ekzistues në Bachelor Kimi dhe i njëjti staf akademik është i përfshirë. Ekspertët kanë thënë po ashtu se njohuritë dhe përvoja e stafit akademik në fushën e kimitë ushqimore nuk është dokumentuar mirë nga Universiteti.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë